



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 7, datë 03.07.2025

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 13:15

Data e mbajtjes së mbledhjes : 03.07.2025

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Gentian Kallmi si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi: Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar këshilltarë ! I nderuar zëvendëskryetar! Të nderuar të pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës.

Në këtë mbledhje, siç jeni vënë në dijeni dhe nëpërmjet email-it të dërguar nga Sekretaria, do të shqyrtojmë dhe miratojmë 4 projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë.

Ftoj sekretaren të procedoj me thirrjen e emrave të këshilltarëve.

Dorina Milja: Përshëndetje ! Fillojmë...

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri...

35 Këshilltarë në sallë.

Denisa Luarasi: : Faleminderit

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen. Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës.

Pika 1.	PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 61, DATË 28.02.2023 PËRSA I PËRKET ZNJ. JETA ÇOADARI
Pika 2.	PËR MIRATIMIN E NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMET E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 35, DATË 03.02.2023 PËRSA I PËRKET Z. ISMAIL SPAHO DHE Z. EDMOND SPAHO, NR. 35, DATË 09.05.2022 PËRSA I PËRKET ZNJ.MANJOLA SEFERI, NR. 72, DATË 20.07.2020 PËRSA I PËRKET Z. SALI KURTI
Pika 3.	PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN NR. 125, DATË 27.07.2023 TË KËSHILLIT BASHKIAK PËR MIRATIMIN PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË PROJEKTIT, SIPAS VKM-SË NR. 17, DATË 18.01.2023, PËR ZHVILLIMIN E PRONËS ME NR. PASURIE 1/27, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “SHESH”, ME SIP.19367.4 M ² ; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/31, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TRUALL”, ME SIP.609.42 M ² ; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/33, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “SHESH”, ME SIP. 2125.51 M ² ; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/168, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TRUALL”, ME SIP. 7518.84 M ² ; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/162, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TERREN SPORTIV”, ME SIP. 2946.04 M ² ; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/159, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TERREN SPORTIV”, ME SIP. 7105.83 M ² ; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/34, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “SHESH”, ME SIP. 1703.31 M ² ; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/32, ZONA KADASTRALE 8513, E LLOJIT “TERREN SPORTIV”, ME SIP. 24827.4 M ² ; NË PRONËSI TË BASHKISË Durrës DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTIT TË ZONËS MULTIFUNKSIONALE PËRRRETH KOMPLESIT TË STADIUMIT “NIKO DOVANA” NË Durrës, PËRFSHIRË STADIUMIN, E LIDHUR MIDIS MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT, BASHKISË Durrës, AGJENCISË SË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT (AKPT) DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH)
Pika 4.	PËR DHËNIEN E MIRATIMIT TË NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS BASHKISË Durrës DHE SPITALLA SOLAR SHPK ME QËLLIM TRANSFERIMIN E TË DREJTËS SË PËRDORIMIT TË INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, KËSAJ SHOQËRIE NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË PARKUT FOTOVOLTAIK TË SPITALLËS ME NJË KAPACITET PREJ 100 MEGAVAT ENERGJI

Keni ndonjë koment për rendin e ditës?

Jemi dakord me rendin e ditës?

Kalojmë në votim?

Kush është pro?

Atëherë, me 35 vota pro, miratohet pa ndryshime rendi i ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 1**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj : Atëherë, përshëndetje të gjithëve.

Komisioni ynë, me shumicë votash, e miratoi pikën 1 dhe fton Këshillin sot që ta miratojë. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Musaraj.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti : Përshëndetje të gjithëve.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike miraton me shumicë votash të kaloi për votim sot në Këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Feshti.

Komente, pyetje, keni për pikën 1?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 1 të rendit të ditës?

Dorina Milja : 35 pro.

Denisa Luarasi : Kundër?.....asnjë

Me 35 vota pro, miratohet pa ndryshime pika 1 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 2**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj : Atëherë, edhe në lidhje me pikën 2, komisioni ynë, me shumicë votash, e miratoi dhe fton Këshillin sot që ta kalojë. Faleminderit.

Dorina Milja : Me falni, pika 1 miratohet me 34 vota pro, se paska lëvizur Dritan Rakipi.

Më falni.

Denisa Luarasi : Po, faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti: Edhe për pikën 2, Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakord të kalojë për votim sot në Këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Feshti.

Komente kemi për pikën 2?

Kalojmë në votim.

Kush është pro pikës 2?

Dorina Milja : 35 pro.

Denisa Luarasi: Me 35 vota pro, miratohet pa ndryshime.

- Kalojmë **në pikën 3**. I jepet fjala për projektvendimin e pikës 3, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj : Atëherë, edhe në lidhje me pikën 3, komisioni ynë e votoi me shumicën e votave dhe ftojme Këshillin që në bazë të ligjit nr. 139/2015, të ndryshuar, të marri miratimin sot ky projekt. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor, zoti Ardian Muka.

Ardian Muka: Edhe komisioni ynë, pas shqyrtimit, pati debate, por me shumicë votash, u aprovua për kalimin sot në mbledhjen e Këshillit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka. Faleminderit.

Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit zonja Blerina Reçi.

Blerina Reçi : Përshëndetje të gjithëve.

Edhe komisioni ynë e aprovoi pikën 3.

Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit Zonja Reçi.

Po z. Muka.

Ardian Muka: Siç e thashë edhe në komision, neve në të dyja komisionet, në fakt, dhe të Zhvillimit Urban dhe atë të Pronave, e ngritëm si problematikë faktin që, siç na ka ardhur pika 3, pra për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin nr. 125 të Këshillit, të datës 27.07.2023, për vënien në dispozicion të projektit sipas VKM-së në zonat kadastrale ëëë.....

Pra, kemi një marrëdhënie të parë, që ka qenë midis Bashkisë Durrës dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, dhe logjika është që u votua në Këshill me një mazhorancë të thjeshtë, sepse diskutohej që toka që vihet në dispozicion nga bashkia është pronë e bashkisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit e investonte Fondi Shqiptar, pra është një ent shtetëror, ndërkohë që nëse nuk jam gabim fondi ishte rreth 65 milionë euro investim, dhe prona i ngelej e gjitha bashkisë. Pastaj bashkia e jepte për zhvillime të ndryshme, ambientet sportive i mbante për vete për aktivitete sportive, dhe ato që propozohej të ishin zhvillime të reja, pra qendra tregtare, hoteleri, zhvillime të tjera rezidenciale, ne në atë kohë thamë që nuk jemi pro këtij lloji zhvillimi, jemi që ajo zonë, meqenëse është e vetmja zonë rekreativo-sportive që ka qyteti i Durrësit brenda qytetit, të vazhdonte të ishte dhe të zhvillohej në të njëjtën mënyrë. Pra, të ishte pronë e bashkisë, ku të mos ketë hotele, apo zona rezidenciale, apo qendra tregtare. Megjithatë, në konceptin e bashkisë është që krijohet një pol i ri dhe në këtë rast kemi fondet, pse mos ta bëjmë. Ne kemi votuar kundër në atë rast, sepse thamë:

nëse ka fonde, atëherë Durrësi ka nevojë natyrisht për një stadium, për një pallat sporti, një zonë multifunkionale, për një pishinë apo një kompleks të ri sportiv, por nuk na duhen pronat e bashkisë të jenë hoteli apo zona rezidenciale, apo qendra tregtare, ndërkohë që kemi shumë problematika të tjera për të zgjidhur me ato fonde.

Propozimi i ri që na vjen sot, dhe këtu theksoj, vjen një propozim i ri, sepse ndryshe nga hera e parë, kur kishim tokë shtet, investim shtet, përfitues përfundimtar ishte po Bashkia Durrës me 100% të pronës. Në zhvillimin e ri kemi parasysh që, është Bashkia Durrës që vë në dispozicion tokën, stadiumin e vjetër dhe gjithë kompleksin, ndërhyr Korporata e Investimeve Shqiptare, e cila është një ent i ri, i ngritur, që do të administrojë, zhvillojë, jep me qira, bënë shumë veprimtari të pronave shtetërore.

Në marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur midis Ministrisë së Arsimit, Bashkisë Durrës, Komitetit Olimpik, Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Korporatës së Investimeve Shqiptare, duhet të kemi parasysh që ky investim, ndryshe nga hera e parë që kryhej nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, i cili në relacion është shkruar që është tërhequr nga ky investim, sepse ka mungesë fondesh dhe për këtë të them të drejtën e kërкова relacionin ose më saktë përgjigjen që ato kanë sjellë, edhe sot nuk na është vënë akoma në dispozicion, përgjigja që ka kthyer FSHZH pse nuk e zhvillon përpara këtë investim. Për momentin Korporata Shtetërore e Investimeve në bashkëpunim me partneritet publik-privat investimin ja jep ta kryej 100% një privati. Pra do zhvillohet një garë, siç thuhet nga marrëveshja, ku bashkia vë asetet në dispozicion, i administron Korporata, por investimi bëhet nëpërmjet garës dhe hyn një kompani apo grup kompanish, të cilat do thonë ne do e zhvillojmë këtë pronë, investojmë me fondet e tyre dhe për këtë, privati merr një përqindje nga zhvillimi i ri që do të bëhet.

Natyrisht, bashkia, sipas marrëveshjes, merr stadiumin e ri, merr një qendër multifunkionale me të gjitha aksesoret e tjerë që ka aty, por në këtë koncept, privati, me të drejtë, i lind e drejta nga Kodi Civil do të marri pjesë nga sipërfaqja e tokës. Këtë patëm debat edhe me pjesën e juridikut dhe thamë: meqenëse këtu ndryshon koncepti, pra ne si Këshill kemi aprovuar në mbledhjen e vitit 2023 një leje ku bashkia nuk tjetërsonte pronën dhe pronat e reja që ndërtoheshin mbi atë territor do mbeteshin të gjitha bashkisë Durrës. Në propozimin e ri që na sillet, ndryshon koncepti. Pra, hyn Korporata Shtetërore, bashkia gjithmonë si pronare e tokës, Korporata Shtetërore vendos një privat për zhvillimin. Privati automatikisht gëzon të drejtën, bazuar në përqindjen që do fitohet në garë, të ketë sipërfaqe si në zhvillim, ashtu edhe në tokë. Sa për të dhëna, sipërfaqja totale e gjithë investimit është 81,600 m²; sipërfaqja që zhvillohet sipas projektit të studios belge është 128,000 m², nga të cilat 69,000 m² janë publike, të cilat janë të detyruara t'i kthehen bashkisë Durrës (ku përfshihet stadiumi, qendra multifunkionale etj.), dhe 59,000 m² janë për zhvillime rezidenciale, hoteleri dhe të tjera funksione të ndryshme, pra janë në funksion të këtij shërbimi privat.

Në këtë moment, unë besoj që Këshilli duhet ta kishte anuluar vendimin e parë dhe të kishte futur për propozim dhe miratim këtë propozim të dytë që na vjen. Pra, nuk mund të bëjmë thjesht një ndryshim fjalësh apo togfjalëshash në vendim, sepse ndryshon komplet koncepti. Në këtë rast, ne po japim në shkëmbim edhe tokë shtetërore. Dhe për dijenin e gjithëve ne, ky organizëm është për të ruajtur natyrisht për të zhvilluar sa më mirë, por për të ruajtur dhe të drejtën e asaj që është pronë shtetërore.

Pra, ne do propozonim dhe këtë ja kërkoja edhe pjesës ligjore të bashkisë, përfaqësueses që kishim aty, të shihet që ne të mos bëjmë gabimin të kalojmë sot në këto kushte dhe një kontestim që mund të vij nesër, të na kthen përsëri në pikën zero dhe do të duhet t'i kthehemi këtij debati në një mbledhje tjetër që mund të zgjasi dhe të ketë kosto për gjithë kanalet e kontestimeve.

Thashë, në koncept, zhvillimi i ri që propozohet është më i mirë se ai që ishte. Sepse nëse më parë, toka shtetërore investohej me lekë shtetërore dhe pastaj do jepej në përdorim privatit, kësaj here është tokë shtetërore hyn një privat, i cili do ta ndërtojë ai dhe me të drejtë, sipas ligjeve të shtetit, atij i lind e drejta që të gëzojë zhvillimin dhe trashëgimin e asaj prone që ka.

Por, në konceptin tonë, si forcë e djathtë, jemi për tjetër gjë: jemi që kjo pronë ti ngeli nga fillimi bashkisë, të zhvillohej nga të gjitha institucionet bashkëpunuese, sepse janë 5 institucione që bashkëveprojnë: Ministria e Arsimit, Bashkia Durrës, Komiteti Olimpik, Federata Shqiptare dhe Korporata. Ai investim që kërkohet, në bazë të atij projekti, të kishim stadiumin e ri, qendrën multifunksionale, zona të gjelbra dhe pole të tjera sportive natyrisht.

Por, në këtë fazë që jemi, duke pasur parasysh që mazhoranca ka forcën e kartonit, ne jemi të detyruar që ta votojmë kundër këtë pikë të projektit që na sillni sot.

Por, vazhdoj të them: përsa i takon pjesës së votimit, sugjerojmë që të shihet me qartësi momenti juridik, si nga ana e bashkisë, por edhe nga ana e Rregullores së Këshillit, meqenëse diskutojmë për tjetërsim të pronës. Pra, në këtë rast do të kishim një votim jo të thjeshtë, por do kishim një votim me shumicë të cilësuar. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit, zoti Muka.

Zoti nënkryetar, doni fjalën?

Gentian Kallmi : Përshëndetje dhe faleminderit për komentin dhe pyetjen.

Në dijeninë time, ju jeni sqaruar dje në komision nga Drejtoria Ligjore e Bashkisë Durrës. Gjithsesi, janë çështje teknike: ndryshimi ose vendimi i ri ka një arsyetim ligjor, sepse, për transparencë edhe për këshilltarët e tjerë, unë ftoj Drejtorinë Ligjore të risqarojë motivin e ndryshimit të VKB-së nr. 125.

Alneida Rroshi (Drejtoresha e Drejtorisë Ligjore): Të nderuar këshilltarë përsa i përket pjesës ligjore, edhe në komisionin ku ishte i pranishëm zoti Muka, është sqaruar qëndrimi i bashkisë në lidhje vetëm me ndryshimin e VKB-së nr. 125, për pikën 2 dhe 3, duke qenë se Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 19.06.2025, i referohet në pikën 2 të Vendimit nr. 125, ku bashkia ka dhënë autorizimin për vazhdimin dhe zhvillimin e të njëjtit projekt të miratuar në janar të vitit 2023.

Qëndrimi jonë është vetëm për ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak. Kjo për arsyetimin, sepse gjithë si këshilltar dhe ne si bashki jemi te qartë se në momentin që nxjerrim një VKB të re, VKB-ja e mëparshme duhet shfuqizohet. Ndaj, nëse shfuqizohet VKB-ja nr. 125, siç e diskutuam në të gjitha mbledhjet e komisioneve të Këshillit Bashkiak, do kishim shfuqizimin e plotë të Vendimit nr. 125. Për këtë arsye, qëndruam në këtë linjë. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit, zonja Rroshi.

Kalojmë në votim.

Po znj. Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, në lidhje me pretendimet e kolegut Muka, të them të drejtën, do kisha preferuar që zoti Muka sot të ishte konçiz dhe të fliste vetëm në lidhje me atë që përmban relacioni. Çfarë do të thotë kjo? Nuk ka ndryshime në koncepte, nuk ka ndryshime në faktin se çfarë roli do ketë bashkia në këtë marrëveshje, por relacioni është shumë i qartë dhe kërkohet vetëm ndryshimi i pikës 2 dhe 3. Për mua, gjithçka tjetër që është thënë është një përsëritje e pretendimeve që zoti Muka ka pasur më parë. Dhe të pretendosh që Korporata e Investimeve Shqiptare nuk është serioze dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka një rol tjetër, unë nuk e di ku e bazon zoti Muka, sepse, në dijeninë time, Korporata e Investimeve Shqiptare është themeluar në vitin 2019 me ligj të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe synon pikërisht, ka si objekt të veprimtarisë së saj të identifikojë dhe të rigjallërojë asetet publike të pashfrytëzuara, për rritje ekonomike të qëndrueshme dhe kjo korporatë është serioze, ka projekte të tjera, që po ju përmend z. Muka shkurtimisht: rikonstruksioni i Pallatit të Kongreseve, rijetëzimi i stadiumit “Selman Stermasi” Tiranë, i stadiumit “Flamurtari” në Vlorë, “Asllan Rusi” etj. Kështu që ka eksperiencë kjo korporatë, është shprehur dhe është gati të financojë dhe pjesa tjetër e marrëveshjes, në dijeninë time, nuk ka asnjë ndryshim, as në rolin që ka bashkia, as në rolin që kanë subjektet e tjera në marrëveshje. Për mua është shumë e thjeshtë dhe shkurt, kërkohet vetëm ndryshimi i pikës 2 dhe 3. Kjo është e gjitha.

Edhe një detaj tjetër, më falni, sepse zoti Muka përmendi si shqetësim edhe çështjen e numrit të votave. Është e vërtetë që ne si grupim socialist, si mazhorancë, i kemi “kartonat”, por ne gjithmonë votimet i bëjmë në bazë të ligjit. Në bazë të ligjit 139/2015, të ndryshuar, nëse doni jua vë në dispozicion, e keni dhe online është e parashikuar që bëhet me shumicë të thjeshtë. Dhe është e vërtetë që është miratuar më parë me shumicë të thjeshtë, dhe sot ftoj Këshillin të respektojë ligjin dhe të zbatojë shumicën që kërkohet në rastin konkret. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit, zonja Musaraj.

Po, Muka?

Ardian Muka: Unë, në asnjë pikë të fjalës time, nuk përmenda që Korporata Shtetërore e Investimeve nuk është organizatë serioze, përkundrazi, nuk kam asnjë problem me këtë. Ajo që unë vazhdoj të them, është që Korporata nuk investon në këtë rast me fondet e saj. Këtu është shumë e qartë në marrëveshje, në pikën 4, ku thuhet që Bashkia Durrës përfiton pjesën takuese në pronë për zhvillim publik, për mbështetje të nevojave të saj, dhe i transferohen stadiumi, pallati i sportit dhe hapësirat e tjera sportive që krijohen nga projekti.

Në pikën 4.3, pjesa takuese e Korporatës dhe e partnerit privat në projektin e investimit do të përcaktohet në kontratën e partneritetit privat, e cila më tej do të parashikojë si vijon:

Në pikën A, thuhet pjesa takuese në pronësi të Korporatës në ndërtimin e ri; në pikën B, pjesa takuese e partnerit privat, e cila përbëhet nga vlera e përcaktuar në procesin konkurrues, si dhe vlera që fitohet nga konvertimi në vlerë ndërtimore e pronës; në pikën C, angazhimi i partnerit privat për të ndërtuar me shpenzimet e tij 100% të objektit të ri.

Më shqip se kaq, besoj nuk ka. Pra, nuk jemi në kushtet e asaj që ne kemi aprovuar në 2023 me 125.

Nëse atëherë kemi FSHZH-në, i cili investon një pronë publike, me një fond publik, prona i mbetet bashkisë Durrës. Në rastin konkret, kemi Bashkinë Durrës që hyn në bashkëpunim me korporatën, por korporata nuk e financon me fondet e saj, por vjen një privat që hedh fondet dhe privati, në bazë të përqindjes që do japi në fitimin e garës që do bëhet, automatikisht i lind e drejta të përfitojë objektet, por edhe tokën nën to.

Automatikisht, nuk jemi në kushtet që ne mund thjesht të ndërrojmë togfjalëshat në projektvendim. Për mendimin tonë, duhet të bëhet një vendim i ri, i cili, meqenëse tjetëron tokën, për të qenë në rregull ne si Këshill, duhet ta kishim votuar me shumicë të cilësuar. Kaq thjesht.

Denisa Luarasi : Je shumë i qartë Zoti Muka. Faleminderit.

Fjalën ja kaloj Komisionit të Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës zonjës Jonada Mamo.

Jonada Mamo: Përshëndetje.

Për të mos u bërë përsëritës, kjo pikë vërtet pati goxha diskutime, por pati edhe sqarime nga zonja Rroshi. Në përfundim, komisioni e miratoi me shumicë për t'ja kaluar Këshillit për votim.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Mamo.

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 3 të rendit të ditës?

Dorina Milja : 27 pro

Denisa Luarasi: Kundër?

Dorina Milja : 8 kundër

Denisa Luarasi: Abstenim?.....

Miratohet me 27 vota pro, 8 kundër, pa ndryshime, pika 3 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 4**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj : Atëherë, edhe në lidhje me pikën 4, me shumicë votash, komisioni ynë e miratoi dhe ne ftojmë Këshillin sot që të japë votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit, zonja Musaraj.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti : Edhe për pikën 4, Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakord të kalojë sot për votim në Këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit, zonja Feshti.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës, zonja Jonada Mamo.

Jonada Mamo : Edhe komisioni jonë e miratoi me shumicë votash dhe fton Këshillin ta votojë. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit, zonja Mamo.

Komente, pyetje?

Kalojmë në votim.

Kush është pro për pikën 4 të rendit të ditës?

Dorina Milja : 35 pro

Denisa Luarasi : Me 35 vota pro, miratohet pa ndryshime pika 4 e rendit të ditës.

- Ka kërkuar fjalën **për diskutim** zoti Sami Osmani.

Sami Osmani : Përsëndetje të gjithëve.

Kam dy-tre shqetësime nga zona e Durrësit të Ri, shqetësime të banorëve këto që janë vërtet shqetësuese.

E para është mungesa e ujit të pijshëm. Ka një muaj që ka mungesë të theksuar të ujit të pijshëm. Para dy-tre ditësh, madje, në një zonë të lagjes 17, uji ka ardhur i ndotur dhe edhe ato pak minuta që ka ardhur, ka ardhur shumë i ndotur. Është bërë ankesë te UKD-ja dhe nuk është marrë asnjë përgjigje.

E dyta, shqetësimi është për fatkeqësinë e 29 janarit për përmbytjen. U trumbetua me të madhe sikur do dëmshpërbleheshin banorët e përmbytur, dhe sot më duket se ka mbetur vetëm në letër, asnjë zgjidhje nuk është marrë për këta banorë dhe arsyeja ndoshta ka qenë, se para zgjedhjeve premtohet, por pas zgjedhjeve premtimet nuk mbahen.

E treta, një shqetësim tjetër është për një rrugë po në këtë zonë, rruga “Vala e Detit”, e cila duhej të kishte përfunduar prej 2–3 vitesh më parë, por ka mbetur rrugëve. Firma zbatuese “Biba X” e ka lënë shumë keq, pusetat janë të hapura. Para ca kohësh, një fëmijë ka pësuar dëmtime për shkak të kësaj situate dhe nuk merret askush me këtë rrugë. Po të kalosh, të gjitha pusetat janë të hapura, është shumë e rrezikshme për fëmijët, për të moshuarit, për këdo, dhe është kthyer si një piste garash, duhen vendosur edhe pengesa për shpejtësinë e makinave. Këto kisha, ju lutem të merren masa dhe të japin përgjigje personat përkatës. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit, zoti Osmani.

Zoti nënkryetar?

Gentian Kallmi: Përsëndetje dhe faleminderit për pyetjet.

Për sqarim, sipas infomarcioneve dhe kontakteve të sotme me institucionin Ujësjiellës Kanalizimeve Durrës nuk na konfirmojnë që ka problematike mungesë uji të pijshëm në zonën e

Durrësit të Ri, por që ka pasur problematika ditët e fundit që kanë prekur të gjithë qytetin e Durrësit dhe njësitë administrative për shkak të një problemi teknik në zonën e Fushë-Kuqes.

Ju lutem pas përfundimit të mbledhjes nëse ka ndonjë rast konkret, edhe ne ta evidentojmë dhe të jemi ndërmjetës me institucionin tonë me UKD, për zgjidhjen e problemit.

Përsa i përket përmbytjeve të janarit, institucioni ynë ka përfunduar në kohë rekord aktet e konstatimeve dhe vlerësimeve, jemi në kontakt të vazhdueshëm me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për fondet. Vlera e përmbytjeve rezulton mjaft e lartë dhe jemi në fazë shqyrtimi për mundësinë e likuidimit të tyre në faza dhe mënyrës së likuidimit të tyre në faza. Do gjejmë mënyrën që t'i likujdojmë me disa faza.

Sa i përket rrugës “Vala e Detit”, ju sqaroj se investitor dhe njësi zbatuese është Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Sipas informacionit që kemi, ka një problem me një banesë për shpronësim, me dokumentacionin në ASHK, për të cilën presim shumë shpejt përgjigjen e ASHK-së, e cila ka penguar një pjesë të investimit, për të vazhduar pasatj me procesin e shpronësimit dhe përfundimin e projektit. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit, zoti nënkryetar.

Duke ju falenderuar për prezencën dhe angazhimin tuaj, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni nga Sekretaria. Faleminderit.

Ky proçesverbal mbyllet me nr. rendor 10 (dhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga drejtuesi i senacës, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i proçesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Drejtues i senacës (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) :

DENISA LUARASI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Këshilltar (Kr. Grupi) :

DRITAN BURGIJA

Këshilltar (Kr. Grupi) :

FLORIAN TAHIRI

Këshilltar (Kr. Grupi) :

ROLANT XHELILAJ